

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e Studimit Bachelor në “Drejtësi”, ofruar nga Kolegji Universitar


“I Biznesit”

Ekspertëte vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Luan Veliqoti



Prof. As. Engjëll Likmeta



(Tetor 2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bsc në "Drejtësi"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "I Biznesit"
2	Fakulteti që e ofron:	Fakulteti i Drejtësisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 651, datë 14.09.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASh Nr. 500, datë 18.10.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "E Drejtësi"
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Numri i studentëve për programin e studimit:	
	15-16	44
	16-17	33
	17-18	26

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në “Drejtësi”

Programi i studimit Bachelor në “Drejtësi” ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë i Kolegjit Universitar “ I Biznesit” (KUB). KUB është krijuar dhe ka funksionuar në zbatim të ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (LAL)” dhe aktualisht funksionon në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Kolegji Universitar “I Biznesit” (KUB), ka filluar veprimtarinë e tij në sistemin e arsimit të lartë si “Akademika Profesionale e Biznesit” me VKM Nr. 651, dt. 14.09.2011. Institucioni është akredituar me Urdhër Nr. 557, datë 16.11.2012 dhe riakredituar me VBA Nr. 100, datë 10.11.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike. Me Urdhër të MASR Nr. 39, datë 30.01.2018 është miratuar Statuti i Institucionit si Kolegji Universitar "I Biznesit".


Programi mësimor i ofruar nga Fakulteti i Drejtësisë pranë KUB, është i AKREDITUAR, bazuar në Urdhrin Nr. 500, datë 18.10.2012 të MASH “Për akreditimin e programeve të studimit Bachelor në “Drejtësi”.

Programi i studimeve “Bachelor” në “Drejtësi” ofrohet nga Departamenti i së Drejtës Publike, pjesë e Fakultetit të Drejtësisë. Ky departament vepron si njësi bazë mësimore - kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinat e drejtësisë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)


Përbërja e GVJ:

1. Prof. As. Luan Veliqoti
2. Prof. As. Engjëll Likmeta



Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Ersi Dako.

Më datë 17.10.2018, Institucioni është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 18.10.2018, përmes AMS dhe shkresës zyrtare Nr. 454 Prot., datë 18.10.2018, Institucioni përcjell komentet në lidhje me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, duke shprehur dakordësinë e tij me Draft-Raportin. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të jashtëm.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

Pas procesit të vlerësimit të jashtëm për programin mësimor Bachelor në “Drejtësi”, në kuadër të akreditimit të parë të tij, Këshilli i Akreditimit, me vendimin Nr. 364, datë 17.9.2012 i ka rekomanduar Ministrin të Arsimit dhe Shkencës akreditimin e këtij programi me rekomandimet e mëposhtme.

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a) Një numër i kufizuar i fondit të bibliotekës me 2000 kopje. Nevoja e pasurimit të këtij fondi dhe nevoja e botimit në periodikë të ndryshëm të drejtësisë.
- b) Nevoja e ristrukturimit të planit mësimor, ku të përcaktohet jo vetëm ngarkesa e studentit në auditor (leksione/seminare), por edhe ajo jashtë auditorit.
- c) Të formatizohen syllabuset e këtij programi studimi, sipas një strukture të përcaktuar, e cila duhet të përmbajë të gjithë zërat e nevojshëm që ka një syllabus.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a) Për rekomandimin e parë, Institucioni ka përmirësuar ndjeshëm situatën e Bibliotekës nën këndvështrimin e ekzemplarëve që disponon dhe që i vihen në dispozicion çdo pedagogu dhe studenti duke e rritur fondin nga 2000 në kohën e akreditimit në mbi 5200 kopje (fizike) në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja. Biblioteka online është një tjetër veçori e infrastrukturës universitare. Prej 3-vjetësh është siguruar aksesimi i stafit dhe studentëve në disa biblioteka elektronike të huaja. Kolegji Universitar “I Biznesit”, ka bërë një abonim me pagesë në një bibliotekë online Questia. KUB ka akses në dy llogari që përdoren nga secili fakultet. Studentët kanë akses të pakufizuar edhe në disa adresa elektronike të cilat janë të afishuara në kompjuterat përkatës në Bibliotekë por edhe në vende të dukshme në mjediset e KUB.
Një fond të veçantë të bibliotekës zë aktualisht dhe promovimii produktit shkencor të stafit akademik ndër vite, botimi i materialeve të trajtuara në Konferencat e përvitshme shkencore të KUB në Proceedings, e cila destinohet për lexuesin e specializuar nëpërmjet botimit të studimeve shkencore në fushat e ekonomisë dhe drejtësisë.
- b) Për rekomandimin e dytë, Institucioni ka riformatuar planet mësimore në të cilat janë pasqyruar si ngarkesa në auditor (leksione/seminare) ashtu edhe ngarkesa e studentit jashtë auditorit, dedikuar për punën e tij të pavarur.
- c) Për rekomandimin e tretë, Institucioni ka përpunuar një format syllabusime të cilin ka punuar dhe aktualisht po i përshtat sipas formatit të VKM Nr.41.datë 24.01.2018, i cili nuk ndryshon esenciansit me atë që ky institucion ka përdorur. Syllabusi i përdorur ka këtë përmbajtje:

- Titulli i lëndës/Modulit;
- Emri, mbiemri i pedagogut;
- Cikli i studimit: Programi;
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda;
- Statuti i Lëndës/Modulit: (tipi A-F);
- Java mësimore;
- Ngarkesa, kredite, Orë në auditor /leksione/Seminare, individuale;

- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit;
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës;
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë;
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik;
- Format e vlerësimit të studentëve;
- Detyrimet e studentit për lëndën;
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.

Sic edhe vihet re, ndryshimi me VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 qëndron vetëm në renditjen e elementëve bazë të syllabusit, që tregon për standardizmin e procesit dhe realizimin cilësor të rekomandimit.

Në përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se rekomandimet e dhëna në Vendimin e Këshillit të Akreditimit në kuadër të akreditimit të parë, janë përmbushur.



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Në statutin e Kolegjit Universitar "I Biznesit" është përcaktuar se misioni i KUB është:

- a. Të formojë specialist të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vëndit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vënd;
- b. Të krijojë, zhvillojë, përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, veprimtarisë innovative e profesionale për fushën e Ekonomisë dhe Drejtësisë.
- c. Të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mesuarit gjatë gjithë jetës;
- d. Të integrojë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor;
- e. Të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit;
- f. Të krijojë e nxisë standarte të larta në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në përputhje me standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë duke reflektuar objektivat e procesit të Bolonjës.

Sa më sipër, konstatohet se KUB, i është përmbajtur tërësisht misionit duke e reflektuar dhe nëprogramet përkatëse në të dyja njësitë kryesore, si në Fakultetin e Ekonomisë dhe atë të Drejtësisë.

KUB, por dhe Fakulteti i Drejtësisë, kanë të përcaktuar objektivat konkret që synojnë të arrijnë dhe se për këtë kanë plane e programe të detajuara mirë, si ato afatgjatë, planin strategjik të zhvillimit, atë afatmesëm të pasqyruar nëkurrikulat e miratuara dhe planin afat shkurtër, të pasqyruar në planin mësimor dhe programet mbështetëse të tij.

KUB ka ndjekur zhvillimin e tregut nga pikëpamja ekonomike e sociale, duke e përshtatur me objektivat konkrete në një plan studimi tregu.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programi i studimit ka të pasqyruar qartësisht të gjitha kërkesat e misionit të institucionit, në të gjitha pikat e tij. Të gjitha programet e KUB janë të akredituara, kanë rregullore përkatëse dhe qartësisht të matshem si në cilesinë e tyre, por edhe një lidhje shumë organike me treguesit e punësimit dhe perspektivën e zhvillimit.
Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	
--	--

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	Zgjerimi i vetvetes në përputhje me tregun e punës, por edhe zhvillimi i dijeve nëpërmjet nje procesi gjithnjë e më të standardizuar, u konstatua nga ana jonë direkt si në hulumtimin e dokumentacionit mësimor, por veçanërisht në kontaktet e drejtpërdrejta me studentët e stafin akademik.
---	---

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Institucioni ka një studim specifik tregu dhe se në përputhje me këtë studim por edhe në bashkëpunim me kompanitë e biznesit, u konstatua direkt një qasje e përgjithshme e programeve të studimit, në nivelin e kornizës 6 të kualifikimeve.</p> <p>Në KUB nuk kishte ndonjë informacion në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi në institucionet simotra.</p>
---	--

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	Programet e studimit në KUB i përfshijnë dhe i zhvillojnë interesat kombëtare dhe në asnjë element nuk ka qasje që të bien ndesh me to.
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i vlerësuar, nga ana jone perputhet plotësisht me misionin e institucionit dhe se krijon hapësirën e duhur të vetëzhvillimit e të arsimimit në nivelet e ndryshme të studimit. Ai me rregullimet lëndore siguron vijimësi dhe mos përsëritje të tij në cikle të ndryshme.
2. Programi i studimit përputhet me studimin e nevojat e tregut. KUB ka realizuar dy studime mbi gjendjen e tregut të arsimimit dhe të punësimit të studentëve të tij. Në bazë të këtyre studimeve KUB ka aplikuar dhe ka marrë licensën për hapjen e programeve të reja të studimit në fushat përkatëse dhe me interes.
3. Institucioni ka plan afatgjatë e afatmesëm të punës së tij, të miratuar në Senatin Akademik.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti përgjegjës për programin e studimit "Bachelor" në "Drejtësi" është Fakulteti i Drejtësisë. Ky fakultet organizohet në tre njësi bazë si më poshtë:

1. Departamenti i së drejtës Publike;
2. Departamenti i së drejtës Civile;
3. Departamenti i së drejtës Penale;

Sipas Statutit të KUB (Neni 11), Fakulteti i Drejtësisë bashkërendon veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore shkencore si dhe veprimtarinë me karakter profesional dhe krijues në fushën e drejtësisë.

Departamenti përgjegjës për këtë program studimi është Departamenti i së Drejtës Publike. Autoriteti drejtues i tij është Përgjegjësi i Departamentit. Sipas Statutit të KUB (Neni 13), Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, që përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore.

Në vitin akademik 2017-2018 secila prej njësive bazë ka në përbërje të saj të paktën 7 pedagogë efektivë, nga të cilët, të paktën 3 prej tyre, me tituj ose grada shkencore. Konkretisht departamentet janë organizuar si më poshtë:

- 1. Departamenti i së Drejtës Publike:** 7 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët: 1 pedagog me titull Prof. As. Dr., 3 pedagogë me gradën shkencore "Doktor", 1 pedagog në proces doktore dhe 2 pedagogë me diplomë Master Shkencor; si edhe 4 pedagogë me kontratë (PAK) nga të cilët: 1 me titullin Prof. Dr., 1 me gradën shkencore "Doktor", 1 pedagog në proces doktore dhe 1 pedagog me diplomë Master Shkencor.
- 2. Departamenti i së Drejtës Civile:** 7 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët: 3 pedagogë me gradën shkencore "Doktor" dhe 4 pedagogë me diplomë Master Shkencor; si edhe 8 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët: 1 pedagog me titullin shkencor Prof.Asoc. Dr., 5 pedagogë me gradën shkencore "Doktor" dhe 2 pedagogë me diplomë Master Shkencor.
- 3. Departamenti i së Drejtës Penale:** 7 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët: 1 pedagog me titullin Prof. Dr., 1 pedagog me titull Prof.Asoc. Dr., 3 pedagogë me gradën Dr., 1 pedagog në proces doktore dhe 1 pedagog me diplomë Master Shkencor; si edhe 6 pedagogë me kontratë (PAK) nga të cilët: 1 pedagog me titullin Prof. Dr., 4 pedagogë me gradën Dr., dhe 1 pedagog me titullin Magistër.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)



Autoritetet drejtuese të Fakultetit të Drejtësisë:

1. Dekani,
2. Përgjegjësit e departamenteve.

Struktura akademike e fakultetit është në përputhje të plotë me kërkesat e misionit dhe programeve mësimore. Në këtë kuptim edhe struktura akademike e departamentit i përgjigjet programit/programeve që mbulon, si për ciklin e parë "Drejtësi" dhe për fushat në ciklin e dytë për të dy programet.

Sa më sipër struktura akademike dhe stafi përkatës, i përmbushin standardet e kërkuara.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Të dhëna për stafin akademik për programin e studimit Bachelor në "Drejtësi" ndër vite, tregojnë se janë përmbushur standardet akademike për mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Duke analizuar të dhënat që kemi në dispozicion nga raporti, por edhe ato të dhënat e tjera të vëna në dispozicion nga Institucioni, vihet re se, nga viti në vit, raporti ndërmjet PAE dhe PAK, ka ardhur gjithnjë duke u ngushtuar si sasi numerike. Personeli përbëhet nga:

- Personeli akademik;
- Personeli administrativ.

Personeli akademik i Fakultetit të Drejtësisë përbëhet nga Personel Akademik me kontratë me kohë zgjatje të pacaktuar dhe me kontratë me afat të caktuar. Personeli akademik kryen veprimtari mësimore, kërkim shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët dhe detyra administrative. Personeli akademik gëzon liri akademike në punën e tij mësimore

dhe kërkimore, në përputhje me aktivitetin dhe statusin që ka. Personeli akademik ndahet në kategoritë “profesor”, “lektor” dhe “asistent lektor”.

Për vitin akademik 2017-2018, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 41 anëtarë, prej të cilëve 26 PAE dhe 15 PAK, me kualifikimin si vijon:

PAE: 1 Prof., 1 Prof.As., 13 Dr., 4 Dr. në proces dhe 7 Msc.;

PAK: 2 Prof. Dr., 2 Prof.As., 3 Dr., 1 Dr. në proces., 1 Magistër dhe 6 Msc.

Titullarët e moduleve të programit të studimit “Bachelor” në “Drejtësi” janë personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Në aspektin numerik, raporti PAE/PAK është 63.4 % PAE dhe 36.6 % PAK, ndërsa nëmbulimin e ngarkesës së programit, raporti është 82 % PAE dhe 22 % PAK. Titullarët e moduleve të cilët janë me kontratë pune kanë të paktën diplomën Master. Ngarkesa për personelin akademik është në përputhje të plotë me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë.

Institucioni nxit dhe mbështet lirinë akademike të stafit pedagogjik si dhe mundëson kualifikimin e mëtejshëm të tij, nëpërmjet: konferencave shkencore që organizohen nga institucioni apo në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit; botimit të artikujve shkencorë në Revistën “Scientific Journal of Professional Studies”, e cila është revistë periodike botuar nga Kolegji Universitar “I Biznesit” me ISSN: 2412-5865, apo revista të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit, në bazë të marrëveshjeve që Kolegji Universitar “I Biznesit” disponon, etj.

Për realizimin e procesit të menaxhimit të përditshëm të KUB si dhe për të zbatuar detyrat që organet kolegjiale të drejtimit, në dispozicion të autoriteteve drejtuese, ka struktura të specializuara të cilat funksionojnë mbi bazën e nevojave që lindin, të konsideruara struktura të përhershme ose struktura ad-hock, të miratuara nga Senati Akademik, Rektori dhe Këshilli i Administrimit.

Kontratat e punës individuale të institucionit me personelin akademik hartohen në zbatim të Kodit të Punës dhe përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve, në respekt të plotë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL të Republikës së Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, lidhur me shpërblimin e drejtë, ngarkesën mësimore, lirinë akademike, angazhimin e pedagogut në aktivitetet shkencore, etj. Kontratat e punës për personelin e KUB nënshkruhen nga Rektori.

Rekrutimi i stafit akademik bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë” si dhe me dispozitat e Statutit dhe Rregullores “Mbi Marrëdhëniet e Punës të personelit të KUB” miratuar nga Senati Akademik i KUB.

~~Punësimi bëhet duke patur parasysh kategoritë e personelit akademik sipas ligjit Nr. 80/2015, në profesorë, lektorë dhe asistent lektorë. Pranë KUB është i mundur pajtimi i personelit të ftuar. Përzgjedhja e punonjësve bëhet nga një komision “ad hoc” i ngritur nga Rektori dhe mbështetet në plotësimin e kriterëve publike të shpalluar nga institucioni për rekrutimin e pedagogëve. Në këtë aspekt KUB ka procedura të plota rekrutimi.~~

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.

Për vitin akademik 2017-2018, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 41 anëtarë, prej të cilëve 26 PAE dhe 15 PAK, me kualifikimin si vijon:

PAE: 1 Prof., 1 Prof.As., 13 Dr., 4 Dr. në proces dhe 7 Msc.;

PAK: 2 Prof. Dr., 2 Prof.As., 3 Dr., 1 Dr. në proces., 1 Magistër dhe 6 Msc.

Për vitet e tjera akademike që prej akreditimit të parë, të dhënat jepen në tabelat 4 dhe 5 të Anekseve.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Stafi akademik për vitin akademik 2017-2018 paraqitet me kualifikimin si vijon: PAE: 1 Prof., 1 Prof.As., 13 Dr., 4 Dr. në proces dhe 7 Msc. ndërsa PAK: 2 Prof. Dr., 2 Prof.As., 3 Dr., 1 Dr. në proces., 1 Magistër dhe 6 Msc. Për vitet e tjera akademike që prej akreditimit të parë, të dhënat jepen në tabelat 4 dhe 5 të Anekseve

- Të dhënat sipas seksit

Stafi akademik për vitin akademik 2017-2018 përbëhet nga 16 anëtare femra dhe 25 anëtarë meshkuj, në raportin 39 % Femra dhe 61 % Meshkuj.

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Të dhënat paraqiten në tabelat 6.1 dhe 6.2 të Anekseve.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontratat e punës individuale të institucionit me personelin akademik hartohen në zbatim të Kodit të Punës dhe përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve, në respekt të plotë të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL të Republikës së Shqipërisë", dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, lidhur me shpërbimin e drejtë, ngarkesën mësimore, lirinë akademike, angazhimin e pedagogut në aktivitetet shkencore, etj. Kontratat e punës për personelin e KUB nënshkruhen nga Rektori.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

KUB, ka të përcaktuar qartë në rregullore të veçanta si institucion, njësi kryesore, por edhe në kontratën e punës për cdo staf akademik detyrat dhe detyrimet reciproke.

Fakulteti i Drejtësisë nuk ka staf ndihmës akademik, ashtu sikundër edhe departamentet nuk kanë staf administrativ.



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Institucioni rekruton stafin akademik në përputhje me kriteret ligjore dhe ndjek një procedurë transparente. Në KUB ka rregullore përkatëse dhe procedura të standardizuara në këtë drejtim. Në aspektin numerik, raporti PAE/PAK është 63.4 % PAE dhe 36.6 % PAK, ndërsa nëmbulimin e ngarkesës së programit, raporti është 82 % PAE dhe 22 % PAK.</p> <p>Në bazë të të dhënave të verifikuara, Fakulteti ka procedura të standardizuara për vlerësimin e stafit akademik, vlerësime të cilat u bëhen me dije individualisht çdo pedagogu.</p> <p>Në Zyrën e Burimeve Njerëzore, mbaheshin dosjet përkatëse dhe të dhënat e plota për stafin akademik.</p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Të dhënat për stafin akademik ishin të plota. Kishte planifikim të drejtë dhe korrekt sipas programit të studimit dhe cilësisë së kërkuar për stafin akademik në disiplinat përkatëse. Institucioni publikon kriteret për rekrutim të stafit akademik dhe përzgjedhja dhe rekrutimi bëhej në mënyrë transparente, të dhëna të cilat u verifikuan edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Të dhënat për stafin akademik, kualifikimin dhe anagazhimin e tij disponoheshin si në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në Fakultet e Departament.</p>
Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga staf akademik dhe administrativ. Laboratori, ai i informatikës administrohej nga Fakulteti Ekonomik por që vihej në përdorim të studentëve të drejtësisë sipas nevojave të tyre. Në Fakultet dhe Departament kishte një ndarje racionale për udhëheqjen e temave të diplomës nga personel i kualifikuar me tituj e grada shkencore. Udhëheqësit e lëndëve kishin gradën shkencore Doktor.</p>

<p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor; Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni ndjek një metodëefikase të rekrutimit të stafit akademik për 1-2 vite pune si asistent pedagog dhe një mënyrë tjetër angazhimi si detyrim në leksionet e hapura dhe punimet shkencore. Minimalisht çdo pedagog duhet të kishte jo më pak se dy artikuj shkencor të botuar ose referime në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Personeli akademik, në këtë program studimi i përmbush kriteret themelore për të zhvilluar një proces mësimor cilësor. Stafi akademik është me eksperiencë në sistemin e drejtësisë shqiptare, me përvojë e arsimim brenda e jashtë vendit. Përgatitja dhe kualifikimi akademik i stafit është një zgjedhje e mire dhe konkurruese, në kushtet e mungesës së një përgatitje profesionale të veçantë siç mund të jenë kurset didaktike. 2. Institucioni rekruton stafin akademik në përputhje me kriteret ligjore, ndjek një procedurë transparente e të standardizuar dhe sipas rregulloreve të caktuar. 3. Personeli akademik me kohë të plotë mbulon 82 % të ngarkesës së përgjithshme të programi të studimit. <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Kolegji Universitar “I Biznesit” ofron një infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha cilket e studimit. Mjediset e tij, të brendshme e të jashtme janë cilësore dhe plotësojnë të gjitha kërkesat e domosdoshme të studentëve, për mësim, studim dhe punë të pavarur. Vendndodhja e Institucionit është në Rr. “Vangjel Noti”, Nr.25, Laprakë, Tiranë.

GVJ, gjatë vizitës në Institucion, vizitoi ambjentet e KUB, si: klasat, auditorë, laboratorët, salla studimi, bibliotekën, por edhe hapësira të tjera të përbashkëta të përdorshme nga studentët. Të gjitha këto ambiente konsiderohen të përshtatshme dhe të mira për plotësimin e kërkesave të studentëve. Gjithashtu u konstatua se edhe për stafin akademik dhe atë administrativ kishte ambiente të përshtatshme dhe të pajisur me infrastrukturë për kryerjen e detyrave të tyre funksionale, të procesit mësimor, por edhe për kryerjen e kërkimeve shkencore. Informacion më i plotë jepet në tabelat 7.1, 7.2, 7.3 dhe 7.4 të Anekseve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit:

- Auditorë/salla mësimi për leksione/seminare, të pajisura me videoprojektorë dhe laptop;
- Mjedise për personelin akademik;
- Mjedise për personelin administrativ;
- Salla për aktivitete promovuese;
- Laborator informatike;
- Mjedise internet-kafe;
- Sallë e dedikuar për Bibliotekën;
- Mjedis për fotokopjime, librari, etj;
- Arkivë/magazinë;
- Shkallë emergjence;
- Ambjent parkimi.

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ Kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qendrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Ambientet në funksion të mësimdhënies, stafit dhe shërbimit ndaj studentit janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme (tabela, video projektor, tavolina, karrige, kompjutera, etj.) që mundësojnë zhvillimin e normal të aktivitetit të përditshëm të institucionit dhe lehtësojnë realizimin me sukses të programeve të studimit të ofruara në KUB. Godina është organizuar për institucion të arsimit të lartë dhe plotëson kriteret teknike si edhe normativat e sipërfaqes së shfrytëzueshme, sipas përcaktimeve të VKM Nr.418, datë 10.05.2017 "Për standardet, Kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre" dhe Udhëzimit të MASR Nr. 21, datë 29.12.2017 "~~Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë~~".

KUB nuk ka mjedise të veçanta për cdo program studimi dhe as për çdo njësi kryesore. Ato janë të përbashkëta por shfrytëzohen në bazë të një planifikimi që bëhet sipas orarit mësimor.

Të dhënat e detajuara për infrastrukturën paraqiten në tabelat 7.1, 7.2, 7.3 dhe 7.4 të Anekseve.

Institucioni disponon një *domain-name* dhe një *domain e-maili*, i cili është implementuar në server-at e Microsoft në mënyrë që të bëhet i aksesueshem nëpërmjet Office 365, apo Outlook Express. Të gjitha pajisjet kompjuterike janë të vendosura në rrjet, i cili kontrollon nga një server mail-server.

Studentët gëzojnë akses të plotë në rrjetin Lan të internetit dhe Ëi-Fi; aksesit sigurohet nëpërmjet IP të dedikuar dhe studentët e stafit akademik mund të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur këtë akses, si për procesin mësimor ashtu edhe për kërkimin shkencor.

Biblioteka është në shërbim të procesit mësimor, edukativ, të formimit profesional dhe të veprimtarisë shkencore që kryhet në institucion. Biblioteka siguron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për persona të tjerë të interesuar. Biblioteka disponon një koleksion prej mbi 5200 ekzemplarësh, që përbëhen nga libra shqip dhe në gjuhë të huaj, në funksion të sigurimit të literaturës bazë dhe literaturës së rekomanduar në programet e studimit të fushës së drejtësisë dhe ekonomisë, që ofron institucioni. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 70 m² dhe krijon mundësi akomodimi të njëkohëshëm, si sallë studimi, për 40 persona në tavolina. Në sallën e Bibliotekës janë instaluar dhe 4 kompjutera (lap top), që janë të pajisur me akses të palimituar në internet. Si salla leximi për studentët janë në dispozicion edhe salla e Laboratorit të Kompjuterave me 26, kompjutera, të cilët janë të lidhur në internet 24 në 24 orë, të cilët mund të përdoren prej tyre dhe pedagogeve. Këto ambiente janë të disponueshme nga ora 09:00 – 20:00. Fondi i bibliotekës, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme mbi bazën e blerjeve dhe donacioneve të vazhdueshme.

I gjithë fondi i bibliotekës është i informatizuar. Çdo vit institucioni kryen blerje të reja të literaturës moderne, të teksteve që përdor stafi akademik për lëndën përkatëse, por dhe libra të cilët shërbejnë si literaturë studimore plotësuese e rekomanduar, që në të shumtën e rasteve janë autorë të huaj që janë personalitete të fushës. Këto nevoja përpilohen nga vetë pedagogët e lëndës dhe KUB bën blerjen e tyre. Në mjediset e bibliotekës shërbehet nga dita e hënë deri ditën e premte, nga ora 8:30 deri 15:00 dhe nga ora 16:00 deri 19:00. Ky orar është i shpallur në mjediset e saj. Gjithashtu ofrohet edhe mundësia e shfrytëzimit të bibliotekës online. Kolegji Universitar "I Biznesit" është i abonuar në bibliotekën online Questia. Në këtë bibliotekë KUB ka akses në dy llogari që përdoren nga secili fakultet. Gjithashtu studentët kanë akses edhe në adresa të tjera si:

<http://www.thefreelibrary.com>

<http://www.gutenberg.org/>,

www.lawlink.coe.int;

www.lawlink.nsw.gov.au;

www.localjuris.com.fr;

www.accessmylibrary.com/;

www.doaj.org;

www.ebsco.com;

www.cobis.al

www.reatprint.com

www.freelebrary.com

Gjithashtu, KUB, ofron për studentet Laboratorin e informatikës me 26 kompjuterash (PC), të cilët janë të lidhur në rrjet dhe në internet non stop, i cili shërben gjithashtu edhe si sallë Interneti. Studentët e programit të Drejtësisë e shfrytëzojnë këtë laborator si për vetëushtrim ashtu edhe për formatimin e punimeve të tyre në procesin e arsimimit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve



Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>KUB ka kapacitetet e duhura për të ofruar literaturën e nevojshme për një program mësimor cilësor. Biblioteka është e pajisur me fondin fizik përkatës si për literaturën e nevojshme ashtu edhe atë ndihmëse. Veç kësaj, edhe nga intervista me studentët, rezulton se ata janë të orientuar në gjetjen e adresave online të bibliotekave elektronike. Institucioni është i abonuar në bibliotekën elektronike Questia si dhe u ofron studentëve akses në disa adresa të tjera elektronike.</p> <p>Departamentet dhe stafi akademik, periodikisht, pasurojnë me botimet e tyre bibliotekën. Çdo vit institucioni kryen blerje të reja të literaturës moderne, të teksteve që përdor stafi akademik për lëndën përkatëse, por dhe libra të cilët shërbejnë si literaturë studimore plotësuese e rekomanduar, që në të shumtën e rasteve janë autorë të huaj që janë personalitete të fushës. Këto nevoja përpilohen nga vetë pedagogët e lëndës dhe KUB bën blerjen e tyre.</p> <p>Në mjediset e bibliotekës shërbehet nga dita e hënë deri ditën e premte, nga ora 8:30 deri 15:00 dhe nga ora 16:00 deri 19:00. Ky orar është i shpallur në mjediset e saj.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që</p>	<p>KUB/Fakulteti i Drejtësisë, ndonëse nuk ka salla të ndara ndërmjet dy fakulteteve, ka mjedise të bollshme për kapacitetin e studentëve qëka. Aktualisht është në prag të funksionimit edhe një mjedis i ri me hapësira për më shumë se 1000 studentë. Klasat dhe sallat për leksione e seminare, por dhe sallat e internetit, biblioteka dhe hollitë brendshëm, ashtu dhe bar kafeja janë të pajisura me kompjuter e sinjal interneti për 24 orë.</p> <p>KUB ka disa laboratorë, por Fakulteti i Drejtësisë ka vetëm atë të Informatikës të cilin e përdor për nevojat e studentëve për tu vetushtruar apo për të zgjidhur detyra me interes të lëndës së zhvilluar. Fakulteti i Drejtësisë ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione, por veçanërisht me studio ligjore, për të realizuar praktikën</p>

zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

profesionale. Ndër to studio ligjore Juris Consulting është parësore.

Konkluzione të GVJ:

1. Nga analiza e hapësirave të raportuara dhe të verifikuara në vend, rezulton se KUB/Fakulteti i Drejtësisë i përmbush standardet për të ofruar hapësirat e mjediset e duhura në funksion të procesit mësimor e kërkimor shkencor.
2. Stafi akademik ka kushte optimale për punë dhe plotëson nevojat e tyre për një proces sa më cilësor.
3. Institucioni ofron literaturën e nevojshme për një program mësimor cilësor. Biblioteka është e pajisur me fondin fizik përkatës si për literaturën e nevojshme ashtu edhe atë ndihmëse. Institucioni është i abonuar në bibliotekën elektronike Questia si dhe u ofron studentëve akses në adresa të tjera elektronike.
4. Çdo vit institucioni kryen blerje të reja të literaturës moderne, të teksteve që përdor stafi akademik për lëndën përkatëse, por dhe libra të cilët shërbejnë si literaturë studimore plotësuese e rekomanduar, që në të shumtën e rasteve janë autorë të huaj që janë personalitete të fushës.
5. Fakulteti i Drejtësisë ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione, por veçanërisht me studio ligjore, për të realizuar praktikën profesionale. Ndër to studio ligjore Juris Consulting është parësore.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

KUB, në drejtim të financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare funksionon konform legjislacionit në fuqi që parashikon dhe rregullon veprimtarinë e Arsimit të Lartë dhe të Shoqërive Tregtare. Institucioni, në mënyrë periodike, çdo vit, auditohet nga një ekspert kontabël i licensuar. Ai konsiderohet korrekt në zbatimin e legjislacionit në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.

Kolegji Universitar i Biznesit siguron burimet e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Ai trajton dhe motivon financiarisht në mënyrë të diferencuar personelin akademik efektiv dhe me kontratë sipas gradave dhe titujve shkencorë. Kolegji Universitar i Biznesit plotëson burimet financiare për fuqizimin e Bibliotekës me fonde të reja librash, mbështet nevojat për kërkimin shkencor dhe Konferencat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështet botimin dhe publikimin e periodikëve të saj dhe të materialeve të konferencave shkencore, mbështet trajnimin në vazhdimësi të stafit akademik dhe atij ndihmës. Kolegji Universitar i Biznesit mbështet me bursa dhe me gjysmëbursa çdo vit rreth 40-50 studentë, me mesatare të lartë apo me probleme sociale dhe ekonomike, që në total arrijnë mbi 50-60 mijë euro në vit.

Informacioni financiar i paraqitur në tabelat 8, 9 dhe 10 të Anekseve prezanton burimet e financimit dhe përdorimin e tyre. Menaxhimi i tyre kryhet nga "Bezo Consulting shpk" dhe "Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes" (ISAB) si entitete të njëjtëve themelues edhe të IAL KUB, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin rakordojnë çështjet financiare dhe menaxhuese.

Në hartimin e treguesve ekonomiko-financiarë, KUB bashkëpunon me departamentet dhe njësitë kryesore të saj, duke marrë në konsideratë kërkesat e tyre për mbulimin dhe realizimin e veprimtarive mësimore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Të dhënat e detajuara jepen në tabelën 8 të Anekseve.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Burimet financiare të KUB sigurohen kryesisht nga tarifrat dhe pagesat e studentëve. Megjithatë investitorët financojnë sa herë që krijohet diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, apo për investime për rritjen e standardeve të procesit mësimor. Burime të dyta, modeste, janë ato që krijohen nga zbatimi i projekteve të fituara për trajnime dhe kualifikime të profesionistëve në fushën ekonomike, siç është ai i Studimit Rajonal për Kontrabandimin e Duhanit. Pjesa më e madhe e shpenzimeve shkon për koston e punës, kryesisht pagat e pedagogëve dhe qirasë së objektit. Trajtimi i stafit akademik në pikëpamje sasiore dhe cilësore ka sjellë rritjen e shpenzimeve. Pagesat e personelit akademik dhe administrativ, sipas kontratave të punës, kryhen në mënyrë korrekte. KUB trajton personelin akademik në pikëpamjen financiare sipas eksperiencës së tyre profesionale, gradave e titujve shkencorë dhe sipas udhëzimeve ligjore. KUB investon në përditësimin e bibliotekës me tituj të rinj, për përmirësimin e infrastrukturës mësimore, si dhe jep bursa për studentët e ekselencës apo në nevojë. KUB ka dëshmuar një gjendje financiare të mirë, të qëndrueshme dhe me kapacitete optimale për të zbatuar standardet që kërkohen për zhvillimin e Arsimit të Lartë. Stafi akademik mbështetet në punën kërkimore shkencore nëpërmjet një fondi të veçantë në të cilin parashikohen financimi i punës kërkimore shkencore në formën e pjesëmarrjes si brenda e jashtë vëndit në konferenca ndërkombëtare, botimet e artikujve të tyre në revistat shkencore, apo në precedents, sigurimi i lejes së pagueshme për kërkimin e mbrojtjen e disertacionit si dhe aktivitete të tjera brenda e jashtë institucionit. Kjo kosto përballohet nga institucioni. Të dhënat e detajuara jepen në tabelat 9 dhe 10 të Anekseve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve



Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga IAL dhe verifikimet e realizuar gjatë vizitës, konstatohet se respektohen të gjitha kërkesat ligjore. Institucioni kryen rregullisht auditim të jashtëm, gjë e cila tregohet në dokumentet shoqëruese si të raportit por edhe të atyre që u konstatuan në vend. Stafi akademik është i mirë informuar për pagesat dhe kontributet personale që derdhen për to.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>KUB, rregullisht kalon në Senat Raportin financiar vjetor dhe përcakton kriteret përkatëse të përdorimit të buxhetit. Në këtë mënyrë vihet re se të ardhurat financiare kanë qënë në rritje dhe se infrastruktura ka ardhur gjithnjë e më shumë në përmirësim. Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare gjatë kohës së zhvillimit të programeve studimore, kryesisht nga tarifat e studentëve, por edhe nga të ardhura dytësore.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ka një auditim periodik të përvitshëm të jashtëm të situatës financiare, për të cilën hartohet një raport financiar, lidhur me kostot e programit të studimit, të ardhurat dhe shpenzimet e kërkuara për zhvillimin me cilësi të procesit akademik. Institucioni dokumenton si të ardhurat edhe shpenzimet, duke qënë transparent për këdo në lidhje me të ardhurat, baza e të cilave janë tarifat e studimit që paguhen nga studentët. 2. Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare gjatë kohës së zhvillimit të programeve studimore, kryesisht nga tarifat e studentëve, por edhe nga të ardhura dytësore. 	
Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore



Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e KUB është krijuar dhe funksionon në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, me Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. NJSBC ka rregulloren e vet të miratuar me vendim të Senatit. Në të shprehet qartë rëndësia e kësaj strukture, detyrat dhe kompetencat e saj në aktivitetin për sigurinë e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike, kërkimore, kulturore e shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si dhe veprimtarisë së personelit administrativ të KUB.

NJSBC është njësi e përhershme dhe e pavarur, e cila synon vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë akademike të KUB. Njësia përbëhet nga 7 anëtarë, (tabela 11 e Anekseve). Në përbërje të saj ka edhe student dhe është organ i përhershëm, me karakter këshillues dhe autonomi operative.

Nga vizita në Institucion, në takimin me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u vu re se parimi i kontrollit të cilësisë së brendshme të të gjithë procesit mësimor është i institucionalizuar. Teknikat e përdorura si intervista, opinione, kontrole në orën e mësimit, vlerësimet e veprimtarisë shkencore etj, kanë qënë objekt i raportit që kjo njësi ka mbajtur në Senat. Këto rezultate kanë vënë në lëvizje strukturat përkatëse për të përmirësuar marredhëniet dhe për të vlerësuar ecurinë e mëtejshme të procesit mësimor por edhe vetë personalitetin e stafit akademik. NJSBC është bërë nismë e marrjes së masave administrative ndaj stafit akademik që ka patur shkelje të etikës së pedagogut.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët:
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qënë hapat e mëtejshëm
 - Etj

NJSBC ka zhvilluar periodikisht anketime e kontrole për çdo vit akademik. Në fund të çdo semestri akademik studentëve u jepet një pyetësor për vlerësimin e performancës së pedagogëve, për çdo lëndë/modul. Përmbajtja e pyetësorëve është standarde. Plotësimi i tyre kryhet në mënyrë konfidenciale. Ky anketim kryhet me të gjithë studentët, sipas viteve dhe grupeve. Përveç pyetësorëve manualë NJSBC e KUB ka zbatuar edhe metodën elektronike. (Tabelat 12 dhe 13 të Anekseve)

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

KUB ka ndjekur një politikë vetëzhvilluese në thithjen e stafit akademik më cilësor. Fakt është se në kohën e vizitës në Institucion, u vu re një pjesëmarrje e gjërë të një stafi cilësor dhe të predispozuar për procesin mësimor. Përzgjedhja dhe procedurat përkatëse janë transparente. NJSBC, në përfundim të pyetësorëve, nxjerr një mesatare vlerësimi për çdo pedagog, si një indikator i rëndësishëm për vlerësimin e performancës së tij, vlerësime të cilat raportohen tek drejtuesit akademikë të KUB.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Veprimtaria e NJSBC reflekton në mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve në proces dhe të diplomuar, në intervistimin e pedagogëve apo të studentëve. Ky proces përfundon me përgatitjen e një raporti vjetor që analizon dhe krahason gjendjen aktuale me standardet shtetërorë të cilësisë që duhet të kenë institucionet e arsimimit të lartë, i cili i paraqitet në formë zyrtare Rektorit, për t'ju vënë dispozicion edhe Senatit. Bazuar në të dhënat dhe rekomandimet e këtij raporti nxirren konkluzione dhe detyra konkrete për përmirësimin e cilësisë të mësimdhënies. GVJ, gjatë vizitës dhe takimit me anëtarë të NJSBC të KUB konstaton se, sipas rastit, rekomandimet e tyre merren në konsideratë nga drejtuesit e KUB, duke e ilustruar edhe me raste konkrete.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimi i kryer në institucionin KUB kryesisht konsiston në përmirësimin e programit të studimit me syllabuset konkrete si në aspektin e kërkesave të tregut të punës, ashtu edhe në përditësimin e tyre me ndryshimet ligjore dhe evoluimin e shkencës e të teknologjisë. Ky proces kryhet në mënyrë të organizuar në nivel departamenti, por edhe nga autonomia akademike e pedagogëve, si dhe përthithen edhe mendimet e studentëve nëpërmjet anketimeve apo pyetësorëve për programin e studimit dhe lëndëve/moduleve.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Vendim i Senatit Akademik Nr. 74, datë 26.07.2017
- Vendim i Senatit Akademik Nr. 47, datë 14.10.2016
- Vendim i Senatit Akademik Nr. 36, datë 16.10.2015

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Fakulteti i Drejtësisë ka të institucionalizuar procesin e vlerësimit, nëpërmjet rregulloreve përkatëse por edhe kërkesave që shoqërojnë programin në syllabuset e çdo lënde/moduli.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;	Ky informacion është pjesë e vlerësimit institucional, në raportin e të cilit është pasqyruar mënyra e vlerësimit dhe metodologjia e tij. Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në raportin vjetor por edhe nëfaqen e internetit. Metodatat e përdorura janë të natyrave të ndryshme, sondazhe, pyetësor, intervista, kontrolle të procesit mësimor etj.
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	
Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:	
Të tërthorta:	
a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;	
b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës,	

<p>kurrikulës, të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p>Metodat e vlerësimit shoqërohen me teste, pikë, notë, vëzhgime në distancë, inspektime, apo edhe direkt dëgjimin e senacave të leksioneve, seminareve dhe provimeve. Këto informacione u evidentuan edhe gjatë vizitës në IAL.</p>
---	---

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni është akredituar institucionalisht me vendimin Nr.100, datë 10.01.2017 nga BA, për 4 vite akademike. Pranë KUB funksionon NJSBC-ja, e cila periodikisht bën vlerësimin e cilësisë së brendshme në institucion duke e shoqëruar për çdo vit akademik me një raport të detajuar për aktivitetin e institucionit në Senatin Akademik. Problemet që ngre NJSBC shërbejnë si udhëzues për përmirësimin e veprimtarisë akademike madje edhe për aplikimin e masave administrative për rastet e shkeljeve që çenojnë etikën e institucionit dhe të procesit mësimor. Politikat e institucionit për ndërgjegjësimin e stafit dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë të materializuara në strategjinë e zhvillimit të KUB, e cila është e publikuar dhe zotërohet nga stafi akademik.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. NJSBC në KUB ka një status institucional të përcaktuar si një njësi permanente me anëtarë të brendshëm por edhe me studentë, çka krijon mundësinë për të operuar me efikasitet në përmirësimin e cilësisë.
2. Siguria në procesin e menaxhimit të cilësisë së brendshme shprehet në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërmjet NJSBC dhe të gjithë strukturave akademike, duke qënë konkret

nëatë që bëhet dhe planifikimin e vazhdueshëm për të siguruar reflektimin e masave që kjo njësi nxjerr në veprimtarinë akademike.

3. NJSBC ka rregulloren mbi të cilën mbështetet e gjithë veprimtaria e saj me autonomi dhe përgjegjësi maksimale për të kryer kontrollin, evidentuar problematikat dhe sugjeruar përmirësime në drejtim të cilësisë.
4. KUB garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron, sipas një metodologjie vlerësimi, me instrumente matëse dhe vlerësuese.
5. KUB publikon rregullisht informacion objektiv, sasior e cilësor për vlerësimin e brendshëm. Kjo veprimtari bazohet në vizionin dhe objektivat e strategjisë së KUB.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Fakulteti i Drejtësisë ofron studime në të dy ciklet: Bachelor dhe Master. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Drejtësi zhvillon studimet me kohë të plotë në 3 vite akademike, në përfundim të të cilave, studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet në planin mësimor pajisen me diplomën Bachelor në Drejtësi.

Objektivi kryesor i programit të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në "Drejtësi" është t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë në fushën e drejtësisë.

Në funksion të këtij objektivi kryesor, programi "Bachelor" në "Drejtësi" synon dhënien e një tërësie njohurish në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e të drejtës, për të siguruar formimin e specialistëve të aftë për të punuar në këtë fushë duke mundësuar përgatitjen e tyre edhe për studime të avancuara. Për realizimin e këtij objektivi, programi parashikon harmonizimin e njohurive, duke filluar me ato bazë teorike, të fushës dhe ndihmëse, duke vijuar me integrimin e tyre edhe me fusha të tjera si ajo kushtetuese, civile, penale, administrative etj.

Në përfundim të programit, synohet që studenti të aftësohet për t'u punësuar në sektorin publik, privat ose si i vetëpunësuar. Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që marrin studentët nëpërmjet tij krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë.

Tregues të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit



Programi i studimit Bachelor në Drejtësi” është hapur në bazë të VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 dhe është akredituar me Urdhër Nr. 500, datë 18.10.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si program studimi i ciklit të parë në Fakultetin e Drejtësisë. Objektivi kryesor i programit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor“ në “Drejtësi” është t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë në fushën e drejtësisë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit Bachelor në “Drejtësi” zhvillohet me 180 kredite (ECTS) në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Fakulteti i Drejtësisë dhe miratuar nga Senati i Kolegjit Universitar “I Biznesit”. Veprimtaria mësimore zhvillohet me 2 semestra në vit, gjithsej 6 semestra. Në programin dhe planin mësimor parashikohen lëndët/modulet me kreditet përkatëse dhe shpërndarja e tyre në vite akademike dhe semestra. Gjithashtu parashikohen edhe shpërndarja e orëve në orë në auditor dhe orë për studim individual të studentit. Në hartimin e plan-programeve është aplikuar sistemi i krediteve, sipas Marrëveshjes së Kartës së Bolonjës. Gjithashtu, në përcaktimin e krediteve, për ngarkesën në auditor e jashtë tij, IAL është bazuar në Udhëzimin Nr.15 datë 04.04. 2008 të MASH. Duke filluar nga viti akademik 2018-2019 do të fillojë të zbatohet VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.

- 1 vit akademik ka: 30 javë mësimore në auditor, ose 60 kredite
- 1 Semestër ka: 15 javë mësimore në auditor, ose 30 kredite
- 1 ECTS: 25 orë mësimore të studentit
- 1 orë mësimore: 50'

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor paraqitet në tabelën 14 të Anekseve.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit (sipas RVB):

- Leksionet: rreth 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret: rreth 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Praktika Profesionale: 10 orë në auditor dhe 70 orë punë e pavarur e studentit
- Punim Diplome: 10 orë në auditor

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara.

Ndryshimet në planin mësimor krahasuar me programin e licensuar jepen në tabelën 15 të Anekseve.

Ndryshimet e bëra në planin mësimor janë gjithsej prej 2 ECTS, duke qenë në përputhje me kërkesat ligjore.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik jepen në tabelat 16.1-16.5 të Anekseve.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.
 - Emërtimi i lëndës/modulit
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
 - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
 - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
 - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
 - Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
 - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
 - Format e vlerësimit të studentëve
 - Detyrimet e studentit për lëndën
 - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

- Analizë e cilësisë së syllabuseve

Nga analiza e syllabuseve, në përmbajtje, specifikat, orët dhe kreditet ECTS, kërkesat ndaj studentëve, njohuritë e nevojshme që transmetojnë tek studentët, rezulton se ato janë në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Nga viti akademik 2018-2019, do të jenë të përshatura edhe nga pikëpamja formale sipas VKM Nr.41, dt.24.01.2018- Shtojca 2, Programi i Lëndës. Në to gjen harmonizim të raportit të orëve në leksion, seminar dhe punën e pavarur të studentit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Ristrukturimi i planeve mësimore sipas Udhëzimit 15

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Programet e studimit në KUB janë të gjithë të akredituar, si të ciklit të parë dhe të dytë. Çdo vit akademik ka 60 kredite.
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve; Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një	Në çdo fillim viti akademik, studentët marrin nga stafi akademik, pedagogu tutor por veçanërisht nga të gjithë pedagogët e moduleve dhe lëndëve informacionin e duhur për programin në tërësi dhe për çdo lëndë në veçanti. Në këto udhëzime janë të

<p>program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>përfshira edhe detyrimet përkatëse apo ngarkesat individuale si detyrime në kuadrin e vlerësimit të vazhduar.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i ciklit të parë Bachelor në “Drejtësi” ofrohet në përputhje me kërkesat dhe standardet përkatëse akademike, si në përmbajtje dhe ngarkesën lëndore në kredite ashtu edhe për përmbajtjen e vetë lëndës sipas fushës. 2. Studenti është qartësisht i njohur me ngarkesën dhe detyrimet që ka në auditor e jashtë tij. 3. Syllabuset dhe literatura janë cilësore dhe përmbushin pritshmërinë e realizimit të objektivave të tij. <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit veprimtaria formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit Bachelor në Drejtësi janë ato të përcaktuara në udhëzimet e MASH, por në të njëjtën kohë janë në përputhje edhe me VKM Nr. 41. datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, si mësimi në auditor, studimi individual, praktika profesionale, përgatitja për provime, dhe temë diplome apo provim formimi.

Mësimdhënia është e organizuar dhe e planifikuar në tre forma kryesore:

- Leksione
- Seminare
- Praktikë profesionale

Raporti midis këtyre tre formave kryesore të organizimit të mësimdhënies është hartuar duke marrë parasysh: Natyrën e objektit të lëndës së studimit; Raportin midis karakterit teorik dhe praktik të çdo lënde; Kërkesat dhe problematikat aktuale për aftësimin teoriko-praktik të studentit. Të dhënat jepen në tabelën 17 të Aneksëve.



Procesi mësimor në programin Bachelor në Drejtësi zhvillohej paradite dhe pasdite me të njëjtin program dhe me të njëjtin syllabus lëndor. Kjo në varësi të anagazhimit të studentëve. Proceset mësimore jashtë auditoreve (praktikat) zhvillohen pranë studiove ligjore, institucioneve qendrore e lokale si dhe komunitetit të biznesit sipas marrëveshjeve me institucionet pritëse.

KUB aplikon rregulla dhe standarde për vlerësimin e studenteve dhe të provuarit të dijes, si : vlerësime të ndërmjetme për njohuritë e marra, vlerësime për aktivizime në seminare, vlerësime për detyra kursi, ese etj, si edhe vlerësim përfundimtar për lëndën, të cilat specifikohen në syllabuset e secilës lëndë. Për nga mënyra e vlerësimit të dijeve janë aplikuar vlerësimi me shkrim, vlerësim me shkrim dhe me gojë si edhe vlerësime me shkrim të sekretuara. Këto mënyra vlerësimi aplikohen me qëllim arrijtjen e një shpërndarje të drejtë të ngarkesës për studentin (jo vlerësim vetëm në fund të semestrit), si edhe për të arritur një studim sistematik të studentit me qëllimformimincilësor të tij.

KUB nuk aplikon statusin e studentit mbetës, duke ofruar lirinë e mbartjes së lëndëve nga studentët. Studenti rezulton mbetës vetëm nëse nuk arrin të marrë të paktën 30 kredite nga viti paraardhës. Studenti që nuk shlyen provimin ose rezulton mbartës për shkak të vlerësimit, ka të drejtën e shlyerjes së provimit të mbartur vetëm në sezonet e riprovimeve.

Raporti midis orëve teorike dhe seminareve, praktike dhe atyre individuale studimore është i balancuar dhe parashikohet në planin mësimor. Mësimdhënia bazohet kryesisht në orën interaktive në të cilën përfshihen në debat të gjithë studentët. Kjo formë e të zhvilluarit të leksionit ka nxitur debatin dhe ka thelluar mendimin shkencor për probleme të ndryshme që lidhen me objektivat e programit të studimit. Lektori realizon mësimdhënie efektive me praktikë të vazhdueshme, duke u bazuar në realitetin vendas dhe krahasimet me sistemet më efektive ndërkombëtare.

Metodologjia e mësimdhënies përbën një pikë të fortë të programit të studimit. Programi mësimor i zhvilluar në këtë mënyrë është nxitës dhe stimulon mendimin kritik, gjë e cila u konstatua edhe nga studentët në takim.

Sasia e krediteve të programit të studimit Bachelor në Drejtësi është e shpërndarë në mënyrë të balancuar mes moduleve/lëndëve mësimore që ofrohen, përfshirë edhe praktikën profesionale me 5 kredite dhe punimin e mikrotezës/provimit të formimit me 7 kredite.

Format e kontrollit të njohurive

Vlerësimi i njohurive të arritura të studentit bëhet sipas sistemeve bashkëkohore europiane. Secili pedagog, duke u bazuar në syllabusin e lëndës, vlerëson shpërndarjen e vlerësimit në ushtrime, laboratorë, detyra kursi etj. Ai kryhet në dy faza: Faza e parë, vlerësimi i studentit përfshin: pjesëmarrjen aktive në leksione 10%, plotësimin e detyrave të kursit dhe testime gjatë vitit 30%, ndërsa faza e dytë, provimi përfundimtar i lëndës i vlerësuar në 60%, metoda të cilat plotësojnë shkallën 100% për vlerësim maksimal. Përqindjet përfundimtare ndahen në segmente për vlerësim me notë. Notat janë nga 4 deri në 10. (Tabela 18 e Anekseve). Pas vlerësimit dhe shpalljes së notës, nëse studentin ka pretendime paraqet ankesë brenda tre ditëve. Vlerësimi me notë i studentëve është proces i kontrolluar dhe i siguruar.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Studentët aktivizohen edhe në aktivitete të Institucionit, si: konferenca shkencore, aktivitete sociale, etj. KUB ka të organizuar jetën studentore nëpërmjet ZMSKK- Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit dhe Karrierës, njësi që asiston dhe ndjek ecurinë e studimeve, gjatë zhvillimit, por edhe

mbas mbarimit të tyre, suksesin dhe vështirësitë e tyre në treg, përgatitja dhe pjesmarrje në konferenca të ndryshme etj. (Tabela 21 e Anekseve)

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

KUB ka unifikuar rregulla të qarta për punën e të gjithë personelit, veçanërisht të stafit administrativ. Në KUB ka një rregullore për veprimtarinë e studentit, në të cilën përcaktohen qartësisht procedurat e pranimit, komunikimi fillestar, deklarata për pranim, kontrata e studentit deri në regjistrimin në programin përkatës.

Cilësia e pranimit të studentëve nga viti në vit ka ruajtur një stabilitet që ofrohet te 6.5 -7.00. Sipas raportimeve përkatëse në këtë program studimi vihet re se po në këto parametra qëndron edhe nota në dalje.

Përsa i përket kohezgjatjes maksimale të studimeve mesatarisht ajo është tek 3.5 vite akademike që do të thotë se ka student që kalojnë për 2 vite akademike kohën normale ashtu sikundër ka edhe student që për shkak të tejkalimit të kohës maksimale, janë çrregjistruar. Ka një numër të vogël studentësh të cilët kanë paraqitur kërkesën për rifillimin e studimeve dhe për ta është ndjekur një procedurë e veçantë e parashikuar në udhëzime dhe në ligj për të kontrolluar qëndrueshmërinë e dijeve apo ekuivalentimin e lëndëve për shkak të ndryshimeve të syllabuseve përkatëse.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

KUB ka procedura transparente për pranimin e studentëve. Studentët njihen me performancën e institucionit dhe më pas nënshkruajnë kontratën. Në funksion të regjistrimit ka edhe një rregullore përkatëse e cila është bashkëlidhur si aneks edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).

Në vitin akademik 2017-2018 janë 26 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 6.93. Të dhëna të detajuara jepen në tabelën 19 të Anekseve.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse).

Në vitin akademik 16-17 janë diplomuar 19 studentë. Të dhëna të detajuara jepen në tabelën 20 të Anekseve.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

KUB ofron mobilitetin e studentëve midis institucioneve të arsimit të lartë brenda vendit. Bazuar në ligjin e Arsimit të Lartë, statutin dhe Rregulloren e vet KUB ofron mundësinë e transferimit të

studentëve në të gjitha vitet e programit të studimit, duke bërë dhe respektuar të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e kërkuar nga MASR. Gjatë vizitës në institucion u verifikuan praktika të kësaj fushe dhe u gjetën korrekte.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Në vitin akademik 16-17, nga 19 studentët e diplomuar, 2 janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 9 jo në përputhje me diplomën. Të dhëna të detajuara jepen në tabelën 20 të Anekeve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Institucioni zbaton procedurat ligjore për pranimin e studentëve në ciklin e parë. Deri më tani KUB nuk ka aplikuar kriteret të veçanta veç atyre të përcaktuara nga ligji. KUB ofron bursa për kandidatët me rezultate të mira. Për të gjithë studentët që në raundin e parë regjistrohen me mesatare 9.6 e lart kanë bursë të plotë, 9-9.5 gjysëm burse dhe për të gjithë ata të cilët rezultojnë me probleme sociale ka mbështetje të veçantë.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët si në faqen e internetit të KUB, por edhe në informacionet e vecanta në fillimin e procesit mësimor dhe në fletëpalosje, marrin informacionin e duhur për programin që duan të ndjekin.</p> <p>Studentët nëpërmjet anketimeve të ndryshme vlerësojnë rregullisht punën e pedagogut. KUB ka zyrën përkatëse për zhvillimin e karrierës dhe një numer të konsiderueshëm institucionesh e firma biznesi bashkëpunuese me bazë marreveshjet kontraktuale të cilët kanë informacione për programet e studimit dhe ndihmojnë shumë në informimin publik.</p>
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit</p>	<p>KUB mban statistika të plota për diplomimet në programet e studimit ashtu sikundër ka një statistikë të plotë për numrin e studentëve për çdo program studimi dhe ecurinë e tyre në këto programe.</p>

<p>akademiknë të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni ka të institucionalizuar në grupet mësimore pedagogun tutor i cili ka kontakt të drejtpërdrejtë me përfaqësuesin e qeverisjes studnetore dhe me çdo student duke koordinuar veprimet për të informuar rregullisht dhe për të ndjekur në vijimësi procesin e arsimimit.</p> <p>Institucioni, nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës, siguron mbështetje për zhvillimin e karrierës për të gjithë studentët duke i orientuar në zgjedhjen e praktikës profesionale .</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni disponon procedura korrekte të regjistrimit dhe të pranimi të studentëve për cdo program studimi, ashtu sikundër edhe studentët janë të qartë për këto procedura. 2. Institucioni ndjek në vijimësi ecurinë e studentit dhe angazhimin e tij, sikundër edhe mban statistika të plota në lidhje me ecurinë, diplomimin e punësimin e studentëve. Ka atraktivitet në krijimin e klimës bashkëpunuese me institucione e firma biznesi për praktikën profesionale e punësimin e studentëve. 	
<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga niësia lidhia e kërkimit me mësimdhënien

Institucioni, për çdo vit akademik ka zhvilluar konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Të gjitha materialet e konferencave janë botuar në precedings dhe tashmë janë pjesë e bibliotekës së KUB. Pedagogë e studentë marrin pjesë në këto konferenca. Pjesëmarrësit kanë qënë nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare. KUB ka bashkëpunim me institucione të ndryshme arsimore si brenda e jashtë vendit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 22 e Aneksëve)

Institucioni publikon revistën periodike "Scientific Journal of Professional Studies" me ISSN 2412-5865, e cila përmban shkrime shkencore të pedagogëve të institucionit, por edhe shkrime të studiuesve jashtë tij. KUB ka publikuar numrin 1 dhe 2 të revistës dhe është në fazën e procedimit për të publikuar numrin 3. KUB ka marrë pjesë si partnere në një projekt kombëtar në kuadrin e "Rritjes së pjesëmarrjes së femrave në biznes", e mbështetur nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale si dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë. Shoqata e Grave Biznesmene të Shqipërisë (ShGPAZ) nëpërmjet një bashkëpunimi me Kolegjin Universitar të Biznesit organizuan projektin "Young Women as job creators", i financuar nga Union of Mediterranean dhe AFAEMME dhe Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme, aktivitet i cili u zhvillua në mjediset e Kolegjit Universitar të Biznesit dhe qëllimi i të cilit ishte promovimi dhe mbështetja e femrave në krijimin apo promovimin e biznesit të tyre. Në fazën e prezantimeve të *start-up*-eve studentët në grupe kanë prezantuar projektet e tyre, ndër të cilat më të mirat u vlerësuan nga juria e aktivitetit.

KUB ka organizuar gjithashtu Konferenca Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare si psh.:

- Konferenca I Ndërkombëtare Shkencore, me temë "Zhvillimet bashkëkohore, sfidat dhe perspektivat", në të cilën kanë marrë pjesë personalitetet akademike dhe shkencore të fushës së ekonomisë dhe drejtësisë nga Universiteti i Krajovës Rumani, Universiteti i Bolonjës Itali dhe Universiteti i Athinës Greqi.. Të gjitha punimet shkencore të konferencës u botuan në revistën Proceedings Book të Konferencës me ISBN 978-9928-123-59-6.
- Konferenca II Ndërkombëtare Shkencore, me temë "Ndryshimi global - impakti ekonomik dhe ligjor". Në konferencë morën pjesë akademikë vendas dhe të huaj, nga Universiteti Britanik i Dubait, Universiteti i Birminghamit, Universiteti i Krajovës, Universiteti i Bolonjës, Universiteti i Tetovës, Universiteti i Prishtinës. Në konferencë janë paraqitur 35 punime shkencore nga pjesëtarë akademikë dhe profesorë vendas dhe të huaj. Të gjitha punimet shkencore të konferencës janë të botuar në revistën Proceedings Book të konferencës me ISBN: 978-9928-123-80-0.
- Konferenca III Ndërkombëtare Shkencore me temë "Sustainable Development and Life Quality Improvement in Albania toward EU Integration process". Në këtë konferencë morën pjesë Ministria e Arsimit, partnerët ndërkombëtar të KUB, nga Britania e Madhe, Universiteti i Sofies - Bullgari, Universiteti i Sienes, Universiteti i Bolonjës - Itali, Universiteti i Kievit - Ukrainë, përfaqësues nga Business Albania, përfaqësues nga Titan group, përfaqësues të lartë dhe pedagogë nga universitete në vend, përfaqësues nga ambasadat e akredituara në Tiranë, si dhe nga institucione dhe ente të administratës publike dhe private. Në seksionet e konferencës janë paraqitur 68 punime shkencore nga profesorë vendas dhe të huaj. Të gjitha punimet shkencore të konferencës u botuan në revistën Proceedings Book të konferencës me ISBN: 978-9928-187-25-3.
- Konferenca IV Ndërkombëtare Shkencore me temë "Reforms in economy and justice, conditions and challenge for albania's european perspective". Në këtë konferencë kanë marrë pjesë përfaqësues nga vende të ndryshme dhe biznese të ndryshme. Në seksionet e konferencës u paraqitën 42 punime shkencore nga profesorë vendas dhe të huaj. Të gjitha punimet shkencore të konferencës u botuan në revistën Proceedings Book të konferencës me ISBN: 978992812380042.
- Konferenca I Kombëtare Shkencore me temë "Pushteti Gjyqësor dhe Integrimi Europian i Shqipërisë" organizuar në mjediset e Akademisë Profesionale të Biznesit. Në këtë konferencë kombëtare pjesë e panelit ishin personalitete të rëndësishme të fushës së drejtësisë nga i gjithë sistemi gjyqësor i vendit, ku përveç temave të diskutimit, pjesëmarrës kanë qenë edhe

studentët e APB-së, të cilët kanë bërë pyetje për t'u njohur më mirë me institucionet, karakteristikat dhe problematikat e tyre, etj.

Gjithashtu, KUB ka mbështetur dhe konferencat shkencore studentore. Në mjediset e KUB janë zhvilluar:

- Konferenca e I Kombëtare Studentore "Young European Leadership", më 17 Qershor 2016, në të cilën morën pjesë 30 të rinj nga universitete të ndryshme publike dhe private nga Shqipëria dhe Kosova si: Universiteti "Haxhi Zeka", Kosovë, Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, etj.
- Konferenca II Kombëtare Studentore "Hapja e negociatave me BE, sfidë dhe mundësi për të rinjtë shqiptarë", më 21 Maj 2018. Pjesë e konferencës, përveç studentëve të KUB, ishin edhe të ftuar të tjerë si dhe studentë nga universitetet e tjera publike dhe private.

Aktiviteti shkencor individual i stafit akademik të KUB evidentohet çdo vit akademik nëpërmjet plotësimit të formularit të standardizuar për këtë aktivitet. Formulari i aktivitetit shkencor është i organizuar si më poshtë:

- ✓ Formular për planifikimin e kërkimit shkencor për vitin akademik, formular i cili plotësohet çdo fillim viti nga pedagogët efektivë të Institucionit;
- ✓ Formulari për realizimin e kërkimit shkencor të planifikuar, i cili plotësohet në përfundim të vitit akademik.

Formularët e sipërpërmendur shërbejnë për evidentimin e performancës shkencore në nivel mikro, për çdo anëtar të stafit akademik.

Në auditoret e KUB ka patur gjithashtu të ftuar lektorë e personalitete nga fusha të ndryshme brenda e jashtë vendit. Sipas të dhënave në dispozicion nga IAL, rezultojnë një listë e gjatë e personaliteteve si nga Këshilli i Europës dhe deri tek drejtues të institucioneve qendrore të vendit.

- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

~~KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione, organizata profesionale dhe komunitetin e biznesit duke siguruar një vijimsi si për kërkimin e hulumtimit shkencor dhe lidhjen e programeve me ekonominë e zhvillimin social ashtu edhe për praktikën profesionale të studentëve.~~

Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar i KUB reflektohet në mënyrën e organizimit të aktiviteteve akademike, në shkëmbimin e eksperiencës së mësimdhënies midis studentëve dhe stafit akademik, në mobilitetin e studentëve, në veprimtari të përbashkëta kërkimore shkencore, si dhe në fushën e botimeve të përbashkëta, me synim sigurimin e shërbimeve më cilësore për studentët dhe personelin akademik.

Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të KUB me institucione të tjera arsimore, të vendit e të huaja, janë materializuar aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si: trajnime për studentët, për

pedagogët, për shkëmbime pedagogësh, shkëmbime studentësh në kuadër të programit ERASMUS+, leksione të hapura etj. Marrëveshjet e nënshkruara të bashkëpunimit të KUB me institucione të tjera arsimore kërkimore dhe të biznesit jepen në tabelat 23 dhe 24 të Anekseve.

Duhet theksuar se mobiliteti i studentëve dhe pjesëmarrja e tyre në aktivitete ndërkombëtare është e kufizuar. Arsytet janë të shumta por kryesisht ato janë të sferës financiare, e cila mund të konsiderohet një detyrë për të ardhmen.

Stafi akademik është mbështetur dhe ka një hapsirë më të madhe në këtë drejtim. Ngelet detyrë në të ardhmen për tu fokusuar në projekte të përbashkëta në fushën e së drejtës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Numri i institucioneve arsimore, të subjekteve të biznesit, të subjekteve publike apo private me të cilat KUB ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi është i konsiderueshëm. Të dhënat e detajuara mbi bashkëpunimin e KUB me institucione kombëtare e ndërkombëtare jepen në tabelën 23 të Anekseve.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.

KUB ka realizuar bashkëpunim me subjekte të rëndësishme të biznesit, por edhe me institucione të tjera të rëndësishme publike dhe private, të cilat shërbejnë jo vetëm për shkëmbim eksperience, për kryerjen e praktikave profesionale, por edhe për punësimin e mundshëm të studentëve. Të dhënat e detajuara jepen në tabelën 24 të Anekseve.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Cjato vizitës në KUB u va re një frymë bashkëpunimi, shkëmbimi informacioni dhe mirëkuptimi midis anëtarëve të stafit akademik në nivel departamenti ashtu edhe në atë institucional. Në institucion ka ndarje të detyrave dhe përgjegjësiive.
Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Fryma e bashkëpunimit nxit dhe inkurajon nisma për projekte të përbashkëta në fushën e aktiviteteve shkencore, por edhe sociale e marrëdhënie të mira ndërpersonale. KUB dhe çdo program studimi ka Këshillin Shkencor të programit i cili inicion debatin për të

përfshirëmendimin e të gjithë pedagogëve në debat. Është pikërisht ky grup, i cili ndan përgjithsisht detyrat sipas kërkesës së programit me qëllim përfshirjen e shumë mendimeve nga stafi akademik dhe jo akademik, si në emertimin e lëndëve sipas tipeve por edhe sasinë e krediteve që i duhet çdo lënde e tipi në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Objektivat e programit të studimit diktojnë bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë brenda e jashtë vendit. Për këtë arsye KUB ka marrëdhënie bashkëpunimi me universitete brenda e jashtëvendit: Universiteti i Durrësit, Vlorës, Elbasanit, UBT, Kolegji Universitar Luarasi, me Universitetin Dimtrie Rumani, Academia Costandiniana Itali, Univ. Alba IULA Rumani, Universiteti i Shkencave të Aplikuara Hungari, Universiteti i Ekonomisë Kombëtare dhe Botërore Bullgari, etj.

KUB ka marrëveshje bashkëpunimi me biznese të rëndësishme në vend të cilët i shërbejnë praktikës profesionale por edhe zhvillimit të trajnimeve të ndryshme profesionale.

Një analizë konkrete të përfitimeve nga keto bashkëpunime nuk u gjet e shkruar, por ajo u evidentua nga të gjithë dokumentacionet se bashkëpunimi është tashmë i institucionalizuar, kjo dukej në pjesëmarrjen e biznesit në konferenca e çorکشope, trajnime, leksione të hapura, e të ftuar nderi.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. KUB ka të institucionalizuar bashkëpunimin në funksion të qëllimit të programit veçanërisht në lidhje me kryerjen e praktikës profesionale, i cili është shumë produktiv.
2. KUB ka vlerësim pozitiv të bashkëpunimit në lidhje me shkëmbimin e eksperiencës ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, si brenda dhe jashtë vendit. Kjo ka sjell qënumri i kufizuar i shkëmbimit të studentëve të kompensohet me shpeshësinë e takimeve reciproke në takime të përbashkëta si në Tiranë edhe jashtë vendit.
3. KUB, vazhdimisht, nëpërmjet strukturave të veta të programeve mësimore por edhe bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë dhe të komunitetit të biznesit, si lektorë të jashtëm, ka krijuar një lidhje organike që i shërben mbajtjes së programeve në linjen e informacionit të zhvillimeve në terren, duke rritur edhe shkallën e punësimit të studentëve.
4. GVJ rekomandon që Institucioni të shohë mundësinë e rritjes së mobilitetit të studentëve.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.

delap
90

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

GVJ konkludon se Institucioni ka përmbushur të gjitha rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Personel akademik i kualifikuar dhe me shumë eksperiencë e përvojë në fushës e së drejtës civile, publike dhe penale.
2. Transparencë dhe qartësi në dokumentacionin e procesit mësimor si regjistrin themeltar të studentëve apo atë të lëshimit të diplomave dhe certifikatave.
3. Marrëdhënie e vertetë dhe e fortë midis profesoratit (Komisioneve të Përhershme si organe kolegjiale) dhe studentëve.
4. Korrektësi dhe seriozitet në të gjithë procesin e dhënies së dijeve nga ana e trupës akademike.
5. Mjedise bashkëkohore për zhvillimin e procesit të mësimdhënies.
6. Hapësirë universitare e gjitha e mbuluar nga rrjeti i internetit.
7. Qasje dhe përpjekje pozitive nga personeli akademik dhe studentët për të zhvilluar më tej lirinë akademike dhe veprimtarinë kërkimore – shkencore.
8. Këshilli i studentëve aktiv, i rregullt dhe i pranishëm në jetën studentore dhe atë universitare të institucionit të arsimit të lartë KUB.

b. Pika të dobëta:


1. Numër i kufizuar i studentëve pjesëmarrës në programe mobiliteti.

c. Mundësitë:

1. Zbatimi i lëvizjes së lirë të stafit dhe studentëve përmes përfshirjes në programet e BE-së Erasmus+ dhe Horizon 2020.
2. Negocimi dhe nënshkrimi i një numri më të madh të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe institucione të tjera.
3. Rritja e vazhdueshme e numrit të programeve të ofruara nga IAL KUB.

d. Pengesat:

1. Pakësimi i numrit të kandidatëve për studentë për shkak të faktorëve të ndryshëm global, demografik, social, ekonomik etj.
2. Zgjatja në kohë e zbatimit të legjislacionit të arsimit të lartë dhe akteve të tij nënligjore.



III. SUMMARY ANALYSIS OF THE EER BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES & THREATS)

a. Strengths:

1. Qualified academic staff with many experience in the field of civil, public and criminal law.
2. Transparency and clarity in the teaching process documentation as the student's fundamental register or the issuance of diplomas and certificates.
3. True and strong relationship between the professorship (permanent commissions as collegiate bodies) and students.
4. Correctness and seriousness throughout the process of teaching by the academic staff.
5. Contemporary environments for developing the teaching process.
6. University campus all covered by internet network.
7. Positive approaches and efforts by academic staff and students to further develop academic freedom and scientific research activity.
8. Active, regular and present student council in the student and university life of the higher education institution KUB.

b. Weaknesses:

1. Limited number of students participating in mobility programs.

c. Opportunities:



1. Implementing the free movement of staff and students through the participation in EU Erasmus + and Horizon 2020 programs.
2. Negotiation and signature of a higher number of cooperation agreements with universities and other institutions.
3. Continuous increase in the number of programs offered by HEI KUB.

d. Threats:

1. The decrease of the number of candidates for students due to various global, demographic, social, economic factors.
2. Time extension of the implementation of higher education legislation and its sub-legal acts.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Luan Veliqoti
2. Prof. As. Engjëll Likmeta


ANEKSE

Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në rang Fakulteti dhe në rang Departamenti per vitin 2017-2018

IAL	Fakulteti i Drejtësisë				
	Numri i PAE		Numri i PAK		Total
	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	
1. Departamenti i së Drejtës Civile	0	Prof. Dr.	1	Prof. Dr.	1
	0	Prof. As.Dr	0	Prof.As.Dr	0
	3	Dr/PhD.	5	Dr.	8
	0	Dr. Proces	0	Dr. Proces	0
	4	Msc.	2	Msc.	6
2. Departamenti i së Drejtës Publike	0	Prof. Dr.	1	Prof. Dr.	1
	1	Prof.As. Dr.	0	Prof. As.Dr	1
	3	Dr.	1	Dr.	4
	1	Dr. Proces	1	Dr. Proces	2
	2	Msc.	1	Msc.	3
3. Departamenti i së Drejtës Penale	1	Prof. Dr.	1	Prof. Dr.	2
	1	Prof.As. Dr.	0	Prof. As.Dr	1
	3	Dr.	4	Dr.	7
	1	Dr. Proces	0	Dr. Proces	1
	1	Msc.	1	Msc./Mg	2
Në total	21		18		39

Tabela 1.1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në rang Fakulteti dhe në rang Departamenti per vitin 2016-2017

IAL	Fakulteti i Drejtësisë				
	Numri i PAE		Numri i PAK		Total
	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	
1. Departamenti i së Drejtës Civile	0	Prof. Dr.	1	Prof. Dr.	1
	0	Prof. As.Dr	0	Prof.As.Dr	0
	5	Dr/PhD.	1	Dr.	6
	1	Dr. Proces	0	Dr. Proces	1
	1	Msc.	1	Msc.	2
2. Departamenti i së Drejtës Publike	0	Prof. Dr.	0	Prof. Dr.	0
	1	Prof.As. Dr.	0	Prof. As.Dr	1
	3	Dr.	1	Dr.	4
	2	Dr. Proces	1	Dr. Proces	3
	1	Msc.	1	Msc.	2
3. Departamenti i së Drejtës Penale	1	Prof. Dr.	1	Prof. Dr.	2
	1	Prof.As. Dr.	0	Prof. As.Dr	1
	1	Dr.	2	Dr.	3
	3	Dr. Proces	0	Dr. Proces	3
	1	Msc.	1	Msc./Mg	2
Në total	21		10		31

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Departamentet përkatëse, për vitin akademik 2017-2018

Fakulteti i Drejtësisë Dep. i së Drejtës Publike							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Ilirjana Nano	Përgj. departamenti	Dr.	1	Vitore Tusha	Dr.	Gjykata Kushtetuese
2	Matilda Meta	Staf akademik	Dr.proces	2	Alket Jaupi	Dr. proces	Av. Popullit
3	Marko Bello	Staf akademik	Dr.	3	Migena Leskoviku	Prof.Dr.	Fakulteti i Shkencave Sociale
4	Çlirim Gjata	Staf akademik	Dr.	4	Shtjefen Zyla	Msc.	Këshilli i Ministrave
5	Enisa Terniqi	Staf akademik	Msc.				
6	Adela Çulani	Staf akademik	Msc.				
7	Kujtim Kapllani	Staf akademik	Prof.As.Dr.				
Fakulteti i Drejtësisë Dep. i së Drejtës Civile							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Danja Hobdari	Përgj. departamenti	Dr.	1	Spartak Bozo	Prof.Dr.	Universiteti i Sporteve
2	Vojsava Gjoka	Staf akademik	Msc.	2	Vasil Dodi	Dr.	Sh.A Alumini
3	Ardian Kasapi	Staf akademik	Msc.	3	Mirela Fana	Dr.	Instituti Sig. Shoqërore
4	Ali Aliaj	Staf akademik	Dr.	4	Ardian Kalia	Dr.	Gjykata rrethit Tiranë
5	Klajdi Gjonedaj	Staf akademik	Msc.	5	Donald Xhelilaj	Msc.	Gjykata rrethit Tiranë
6	Emiljan Mustaqe	Staf akademik	Dr.	6	Mirela Selita	Dr.	
7	Brunilda Hoxha	Staf akademik	Msc.	7.	Bernina Kondi	Dr.	
				8.	Olta Hadushaj	Msc.	
Fakulteti i Drejtësisë Dep. i së Drejtës Penale							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Mirgen Prence	Përgj. departamenti	Dr.	1	Henrik Ligori	Dr.	Gjykata e Krimeve të Rënda
